**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

**OSHP: 2025/0239**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori Kryetare duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "TV LLAPI" SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të "KUVENDI KOMUNAL VITI" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbimet e ndriçimit profesional, binës, akcesorëve dhe zërimit për nevoja e Autoritetit kontraktues" me numër të prokurimit 657-25-1029-2-2-1, me 06/05/2025, mori:

# Vendim

**1. Aprovohet,** si e bazuar ankesa e OE "TV LLAPI" SH.P.K. me nr. 2025/0239, e datës 04/04/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbimet e ndriçimit profesional, binës, akcesorëve dhe zërimit për nevoja e Autoritetit kontraktues" me numër të prokurimit 657-25-1029-2-2-1.

**2. Anulohet** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të "KUVENDI KOMUNAL VITI", ndërkaq aktiviteti i prokurimit "Shërbimet e ndriçimit profesional, binës, akcesorëve dhe zërimit për nevoja e Autoritetit kontraktues" me numër të prokurimit 657-25-1029-2-2-1 kthehet në **Rivlerësim.**

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik "TV LLAPI" SH.P.K.

5. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

# Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 20.02.2025, "KUVENDI KOMUNAL VITI" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Shërbimet e ndriçimit profesional, binës, akcesorëve dhe zërimit për nevoja e Autoritetit kontraktues" me nr. të prokurimit: 657-25-1029-2-2-1. Ndërsa me datën 21.03.2025 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie te kontratës.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurën e hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 15,000.00 €.

Me 24.03.2025, OE "TV LLAPI" SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 27.03.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 04/04/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "TV LLAPI" SH.P.K., me nr. 2025/0239 për lidhur me aktivitetin "Shërbimet e ndriçimit profesional, binës, akcesorëve dhe zërimit për nevoja e Autoritetit kontraktues" me nr. të prokurimit: 657-25-1029-2-2-1.

***-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-***

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

***Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "TV LLAPI" SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:***Ne si Operator Ekonomik ankues: TV LLAPI SHPK" – Podujeve, me datën 21.03.2025., kane pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-se – Komuna e Vitisë, ku është rekomanduar për dhënie te kontratës një operatori ekonomik me çmim me te lart se oferta jonë , sipas letrës standarde te datës 21.03.2025.ne jemi eliminuar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, kompania jone, rrjedhimisht si arsyetim te eliminimit AK – zyra e Prokurimit ka potencuar:

1. Nuk keni plotësuar kriterin për vlerën e kontratave te realizuara ne bazë te kërkesës se DT Prandaj bazuar ne nenin 108/A te LPP-se dhe ne afatin parapare me LPP, paraqesim këtë: ANKESË

Argumenti 1: Në bazë të kërkesës se DT Kërkesa 1. Kontrata te projekteve për shërbime te ngjashme, minimum sa vlera e planifikimit ne tri vitet e fundit, nga data e publikimit te Njoftimit për kontrate. ne si OE kemi prezantuar një listë te kontratave te realizuara ne tri vitet e fundit dhe se te gjitha kontratat tona korrespondojnë me ketë veprimtari te kërkesës se DT,AK ose nuk e ka vërejt fare ketë faill të ngarkuar ose e ka anashkaluar me qellim në mënyrë qe ne si OE i përgjegjshëm ne bazë te kërkesave te DT të mund të shpalleshim fitues me ketë rast ka shkelur ligjin e prokurimit publik rregulloren si dhe udhëzuesin rregullativ. AK pas kërkesës sonë për rishqyrtim potencon se ne bazë te paramases ne nuk i kemi plotësuar kriteret e DT dhe se kontratat dhe referencat e tjera nuk kanë dëshmi bankare, në ketë rast AK Komuna e Vitisë kërkon diçka te cilën nuk e ka qen ne DT sepse ne DT askund nuk shkruan se

kontratat dhe referencat me operatoret privat duhet te dëshmohet me transaksione bankare edhe pse ka mund te kërkoj sqarime.Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi Ne ketë rast oferta jon nuk është trajtuar e barabartë me ofertat e tjera ne po prezantojmë edhe një her si dëshmi listën dhe kontratat te cilat janë ngarkuar failli ne nr 2 i cili asht ne dosjen e dorëzuar përmban listën si dhe kontratat se bashku me referencat, si dëshmi po u përcjellim edhe një her.

Lista e kontratave te TV Llapit SHPKDuke u referuar pretendimeve si më sipër "TV LLAPI" SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në Ligji me nr. 04/L-042, për Prokurim Publik Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave 3/12 Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve Rregullorja me nr. 001/2022, për Prokurim Publik Neni 38 Sqarimi i Tenderëve Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve Udhëzuesi me nr. 001/2023, për Prokurim Publik - Neni 10 sqarimi i tenderi. Siç shiftë edhe ne fotot e ngarkuar me vetëm një kontratë e kalojmë shumë her shumen e kërkuar ne DT andaj kërkojmë nga OSHP që te merret vendim: V E N D I M I. Te aprovohet ne tërësi si e bazuar ANKESA e OE TV LLAPI SHPK II. Te anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-se i datës 21.03.2025, si i kundërligjshëm dhe lënda te kthehet ne Rivlerësim; III. Te formohet komision rivlerësues, neutral, njohës dhe zbatues i dispozitave ligjore te Prokurimit Publik; IV. Te kualifikohet si e përgjegjshme oferta e OE- TV LLAPI SHPK si e përgjegjshme me çmimin me te ulet V. Te obligohet AK komuna e Vitisë te kthehet lënda ne rivlerësim VI. Te lejohet kthimi i mjeteve te deponuara ne emër te ankesës.

***Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim:*** Refuzohet si e pabazuar, kërkesa për rishqyrtim e Kompania "TV LLAPI SH.P.K''" për projektin: "Shërbimet e ndriçimit profesional. bineës. akcesorëve dhe zërimit për nevojat e Autoritetit Kontraktues me numër te prokurimit VI657-25-1019-2-2-1.Arsyetim: Zyrtari prokurimit, Bazuar në nenin 108/A, pika 10.2 të LPP. AK merr këtë vendim pasi që Kompania "TV LLAPI SH.P.K" nuk ofron argumente me të cilat i arsyeton pretendimet ankimore.Pretendimet ankimore, mbi të cilat ka ushtruar kërkesën për rishqyrtim, nuk janë të bazuara ,pasi që nuk arrin të arsyetoj argument të qëndrueshëm. Edhe pse ai ofron listën e kontratave Lista e kontratave dhe referencat e prezantuara nuk dëshmojnë se keni përmbushur kërkesën e paraqitur ne DT, ne listën e kontratave te paraqitura keni prezantuar një kontratë me te cilën pretendoni se keni përmbushur kriteret e kërkuara, kontrata me titull: Kontraktimi i shërbimeve për shënimin e aktiviteteve kulturore dhe përcjelljen mediatike te punëve te Komunës së Podujevës, e ne atë kontrate është e paraqitur tabela me punët te cilat duhet te kryhen nga OE dhe vetëm dy nga pozicionet ne tabel .pozcioni 6 dhe 11 janë të natyrës së kërkuar e te cilat nuk përmbushin vlerën e parashikuar te kërkuar sipas DT, ndërsa kontratat e prezantuara te lidhura ne mes te OE nuk kanë dëshminë e pagesës bankare te kërkuara sipas ligjit. Andaj AK ka vendosur si ne diapozitiv te këtij vendimi duke marr parasysh argumentet e prezantuara deri tani se OE nuk ka ofruar dëshmi qe vërtetojnë ankesën e tij andaj AK vendosi si me lart.

## *- Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 10.04.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0239/2025, ndërsa me datë 10.04.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 0239/2025 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Lidhur me pretendimet e OE "TV LLAPI" SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0239 ka vlerësuar si në vijim:

***ANALIZA E EKSPERTIT SHQYRTUES***

Eksperti shqyrtues ka analizuar me kujdes pretendimet ankimore të ankuesit dhe vendimet e Autoritetit Kontraktues (AK), duke paraqitur konstatimet dhe vlerësimet e tij si më poshtë:Pretendimi Ankimor: Operatori Ekonomik "TV LLAPI SHPK" kundërshton vendimin e Autoritetit Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal për eliminimin e ofertës së tij, duke e konsideruar atë të pabazuar, të paargumentuar dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Sipas ankuesit, arsyeja e eliminimit ishte mungesa e dëshmive bankare për kontratat dhe referencat e paraqitura në ofertë, të cilat nuk vërtetonin realizimin e kontratave të kërkuara në DT.Ankuesi thekson se një kërkesë e tillë nuk ka qenë e përcaktuar në dokumentacionin e tenderit dhe paraqitja e dëshmive të tilla nuk ka qenë kriter ligjor për kualifikim. Për më tepër, në ofertën e dorëzuar janë bashkangjitur kontrata dhe referenca për shërbime të ngjashme, me vlera që tejkalojnë planifikimin buxhetor të projektit, duke përmbushur në mënyrë të plotë kërkesat e Dosjes së Tenderit.Gjithashtu, ankuesi thekson se AK nuk ka kërkuar sqarime për këtë çështje, ndonëse ka pasur hapësirë ligjore për ta bërë një gjë të tillë në bazë të nenit përkatës të Rregullores Nr. 001/2022 dhe Udhëzuesit për Prokurim Publik. Mos kërkimi i sqarimeve përbën shkelje të rëndë të parimit të barazisë dhe transparencës në procedurë.Ankuesi kërkon shfuqizimin e vendimit të eliminimit dhe rivlerësimin e ofertës në përputhje me dispozitat e LPP-së dhe rregulloret në fuqi.

***Përgjigje në Pretendimin Ankimor:*** Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i ankuesit është i bazuar, pasi AK ka eliminuar ofertën e OE "TV LLAPI SHPK" duke vendosur kritere shtesë, të cilat nuk kanë qenë të përcaktuara në Dosjen e Tenderit (DT) dhe në Fletën e Të Dhënave (FDT).Në njoftimin për kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, është kërkuar në mënyrë të qartë që operatorët ekonomikë të dorëzojnë:Kërkesa 1: "Kontrata të projekteve për shërbime të ngjashme, minimum sa vlera e planifikimit në tri vitet e fundit, nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Lista e projekteve të realizuara për shërbime të ngjashme për tri vitet e shkuara së paku sa vlera e planifikimit, bashkë me referencat, nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, bashkangjitur referencat e shërbimeve si dëshmi dokumentare."Gjatë analizimit të dokumenteve të tenderit në platformën e-prokurimi, eksperti shqyrtues ka gjetur se OE "TV LLAPI SHPK" i ka dorëzuar kontratat dhe referencat përkatëse, të cilat përfshijnë projekte të natyrës së ngjashme me objektin e prokurimit dhe me vlerë sipas kërkesës së AK-së. Po ashtu nga krahasimi i ofertës së ankuesit me operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë, rezulton se ankuesi ka ofruar çmim më të ulët, i cili përbën kriterin për dhënien e kontratës sipas DT-së.Eksperti shqyrtues, duke u bazuar në dokumentet e publikuara në platformën e-prokurimi, ka gjetur se në njoftimin për eliminim AK ka deklaruar se: "Nuk keni plotësuar kriterin për vlerën e kontratave të realizuara të kërkuara sipas DT-së", ndërsa në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim AK ka deklaruar se: "Kontratat e lidhura mes OE-së nuk kanë dëshminë e pagesës bankare të kërkuara sipas ligjit."Arsyetimi i AK-së në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim, sipas ekspertit shqyrtues, përbën një ndryshim të kërkesave të dokumentacionit të tenderit, duke shtuar një element të ri që nuk figuron në njoftim për kontratë apo në DT. Një qasje e tillë, sipas ekspertit shqyrtues, mund të ndikojë në qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e procesit të prokurimit publik.Tutje, eksperti shqyrtues sqaron se, në pajtim me nenin 59 dhe nenin 72 të LPP-së, në rast se AK kishte ndonjë paqartësi ose dilemë në lidhje me dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik, do të ishte e arsyeshme dhe në përputhje me parimet e ligjit që të kërkonte sqarim të tenderit. Kjo, megjithatë, nuk është bërë.Eliminimi i ofertës së OE-së pa kërkuar sqarime shtesë dhe përmes shtimit të

kritereve në mënyrë retroaktive (siç është kërkesa për dëshmi bankare), sipas ekspertit shqyrtues, nuk është në pajtim me nenin 7, nenin 52, nenin 56 dhe nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik, të cilët garantojnë:Barazinë në trajtim,Mospërdorimin e kritereve të paqarta apo të papërcaktuara paraprakisht,Transparencën e procesit të vlerësimit,Rregullat për ekzaminimin dhe krahasimin e ofertave.

PËRFUNDIMI: Eksperti shqyrtues rekomandon që ankesa e OE "TV LLAPI SHPK" të konsiderohet e bazuar dhe që lënda të kthehet në rivlerësim, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik. Gjetjet e shqyrtimit sugjerojnë se vendimi për eliminim nuk është mbështetur në kushte të qarta dhe të dokumentuara paraprakisht, ndërsa vlerësimi i ofertës nuk ka reflektuar plotësisht parimet e barazisë dhe transparencës. Në këtë kontekst, eksperti shqyrtues propozon që rivlerësimi i ofertës të bëhet në mënyrë të paanshme, të kujdesshme dhe në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

***- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –***

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në Rivlerësim për AK i cili obligohet të veproj në harmoni me rekomandimet e ekspertëve shqyrtues/teknik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim, dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin "Shërbimet e ndriçimit profesional, binës, akcesorëve dhe zërimit për nevoja e Autoritetit kontraktues" me nr. të prokurimit: 657-25-1029-2-2-1. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues "TV LLAPI" SH.P.K., dhe se argumentimi në raportin e ekspertes është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertes mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "TV LLAPI" SH.P.K., janë të bazuara.

Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit e sheh si të bazuar, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit me "Shërbimet e ndriçimit profesional, binës, akcesorëve dhe zërimit për nevoja e Autoritetit kontraktues" me nr. të prokurimit: 657-25-1029-2-2-1, të anulohet njoftimi për dhënie dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Per pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Kimete Gashi**

**Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI KOMUNAL VITI**
- OE - **" TV LLAPI " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: